



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

ARSIMIMI NË GJUHËN SERBE DHE VERIFIKIMI I DIPLOMAVE NË KOSOVË

MAJ 2018



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



NORWEGIAN EMBASSY

Bashkëfinancuar nga Ambasada
Mbretërore e Norvegjisë në Prishtinë

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

1. HYRJE

Arsimi në Kosovë është i organizuar në dy sisteme paralele. Sistemi arsimor i Kosovës është i organizuar në gjuhën shqipe, boshnjake, turke dhe atë rome, dhe mësimet në të i ndjekin pjesëtarët e komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të tjera jo-serbe. Arsimimi në gjuhën serbe është i organizuar dhe udhëhequr nga Ministria e Arsimit të Serbisë dhe në të mësimet i ndjekin pjesëtarët e komunitetit serb dhe të komuniteteve që përdorin gjuhën serbe (kryesisht goranë, romë dhe boshnjakë). Institucionet e arsimimit në gjuhën serbe, të cilat përfshijnë të gjitha nivelet e arsimit, funksionojnë në të gjitha pjesët e Kosovës ku jetojnë pjesëtarë të komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera serbisht-folëse. Ashtu siç është gjendja aktualisht, ky rrjet është plotësisht i ndarë nga sistemi arsimor më i gjerë i Republikës së Kosovës.

Sistemi arsimor në gjuhën serbe nuk njihet nga Kosova, dhe, meqë jemi në këtë pikë, as sistemi i Kosovës nuk njihet nga sistemi i Serbisë. Ndonëse Kushtetuta e Kosovës garanton arsimimin në gjuhën serbe, dhe, për më tepër, mundëson përdorimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore nga Republika e Serbisë, kjo është e paraparë të bëhet përmes një kompleksi marrëveshesh reciproke ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të cilat akoma nuk janë lidhur. Prandaj, praktikisht të dy sistemet ekzistojnë pranë njëri-tjetrit, pa ndonjë ndërveprim. Kjo gjendje ka mbretëruar që nga viti 1999, me vendosjen e Administratës së OKB-së në Kosovë, dhe ka vazhduar edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Përveç shumë çështjeve politike, arsimore dhe kulturore që dalin si pasojë e kësaj ndarjeje, një çështje kyçe praktike e cila bllokoi qasjen e serbëve dhe komuniteteve të tjera në arsim dhe punësim është mosnjohja e diplomave të një sistemi nga tjetri. Mosnjohja praktikisht u pamundëson individëve të kapërcejnë ndarjen midis dy sistemeve. Në vijim japim një përmbledhje të shkurtër të punës që është duke u bërë në trajtimin e kësaj çështjeje, punë kjo që po udhëhiqet nga Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë.

2. VERIFIKIMI I DIPLOMAVE: HISTORI I NDËRLIKUAR, GJENDJE KOMPLEKSE

Në kuadër të Dialogut të Brukselit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, të lehtësuar nga ana e BE-së, në prill 2013 të dy vendet ranë dakord të njohin diplomat e arsimit të lartë (universitare). Marrëveshja parashihte një palë të tretë ndërmjetësuese, dhe një proces shumë të ndërlikuar. Qysh në vitin 2014 Raporti i Progresit e Komisionit Evropian kishte vënë në dukje se bashkëpunimi kishte ngecur pasi që në Serbi ishin njohur vetëm pesë diploma nga Kosova. Gjykata Kushtetuese e Serbisë e kishte shfuqizuar dekretin e Qeverisë për njohjen e diplomave në vitin 2014, dhe, ndonëse Qeveria kishte nxjerrë një dekret të ri disa javë më pas, deri më tani procesi konsiderohet plotësisht i bllokuar.¹ Tre vjet pas ratifikimit të saj, konsiderohet “me të vërtetë tragjike” që sistemi arsimor i Kosovës ka mbetur krejtësisht i ndarë dhe pa qëllime të mirëfillta për përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e arsimit.² E vetëdijshme për të metat e Marrëveshjes së Brukselit në aspektin e zhvillimit të një kornize funksionale për arsim në mes të Kosovës dhe Serbisë, ECMI Kosova ka integruar reformën në arsim në agjendën e vet dhe po kontribuon në zgjidhjen e ngërçit me anë të një numri veprimesh.

Një nga çështjet e një rëndësie të madhe për pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë, e cila ka mbetur e pazgjidhur në marrëveshje, është ajo e pozitës së Universitetit të Mitrovicës Veriore (UMV), i cili është i vetmi institucion i arsimit të lartë që ofron mësim në gjuhën serbe në Kosovë. Sipas Kushtetutës së Kosovës, si dhe Ligjit për Arsimin e Lartë³ dhe Ligjit për Arsimin në Komuna⁴, të dyja të vitit 2008, Komuna e Mitrovicës së Veriut gëzon kompetenca të zgjeruara në arsimin e lartë, dhe UMV njihet si institucion publik autonom nën autoritetin e Komunës.⁵

1. Bureau for Social Research, Report on the Implementatino of the Brussels Agreement (by the Republic of Serbia), June- December 2014, p. 14; Institute for the Study of Human Rights (Columbia University). Implementation Review of the Kosovo-Serbia Dialogue, 5 September 2017, p. 1

2. Gëzim Krasniqi, ‘The challenge of moving from normalized dialogue to normalized relations’, Pristina Insight, 19/04/2016, në dispozicion në: <http://prishtinainsight.com/challenge-moving-normalised-dialogue-normalised-relations/> [accessed 22/05/2018]

3. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>

4. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>

5. Komisioni Evropian. Shkurt 2017. Overview of the Higher Education System: Kosovo, fq. 8-9

Megjithatë, deri më tani UVM vazhdon të funksionojë në kuadër të sistemit arsimor të Serbisë, nën emrin “Universiteti i Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicë”.^{6,7} Në nivel të institucioneve, marrëveshja mbulon vetëm institucionet që veprojnë brenda Republikës së Serbisë dhe institucionet e arsimit të që veprojnë nën fushëveprimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.⁸ Marrëveshja nuk mbulon institucionet e udhëhequra nga Serbia që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Shikuar praktikisht, ky është thelbi i problemit për popullsinë serbe dhe atë serbisht-folëse që jeton në Kosovë, pasi që të gjitha diplomat e tyre shkollore lëshohen nga sistemi i Serbisë që vepron brenda Kosovës, e të cilat nuk mbulohen nga Marrëveshja e Brukselit.

Që nga viti 1999, të diplomuarit në institucionet arsimore në gjuhën serbe në Kosovë, nga të gjitha nivelet, nuk kanë mundur të përdorin diplomat e tyre brenda sistemit të Kosovës. Praktikisht, ata nuk kanë mundur të përdorin diplomat e tyre për punësim në ndonjë pozitë në kuadër të institucioneve të Kosovës. Kjo jo vetëm që ka penguar qasjen në arsim dhe punësim të pjesëtarëve të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera që ndjekin arsimin në gjuhën serbe, por gjithashtu, në shkallë më të gjerë, bllokoi integrimin e tyre në Kosovë. Në vitin 2015, me ndërmjetësimin e ECMI Kosovës, Ministria e Arsimit të Kosovës dhe Universiteti i Mitrovicës së Veriut kanë arritur një marrëveshje për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut. Rregullorja e Qeverisë së Kosovës nr. 21/2015 (e dhjetorit 2015), e cila ishte hartuar me kujdes dhe negociuar me përfaqësuesit e Universitetit të Mitrovicës së veriut, bënte të mundur, për herë të parë pas luftës, verifikimin e diplomave të lëshuara nga institucioni i vetëm i arsimit të lartë që vepron në gjuhën serbe në Kosovë, dhe rrjedhimisht njohjen e tyre për procedura të punësimit në të gjitha institucionet publike të Kosovës.

⁶ Qendra për Arsim e Kosovës. 2014. Analizë e shkurtër e gjendjes në sektorin e arsimit në Kosovë, fq. 12

⁷ Punë e madhe: mbikëqyrja civile e zbatimit të marrëveshjeve Kosovë – Serbi, Raport #1, nëntor 2014, fq. 39

⁸ Tekstin e plotë të Marrëveshjes e gjeni në <http://www.thebalkansdaily.com/full-text-of-agreement-between-belgrade-and-pristina/> [qasur më 15/05/2018].

Që nga fillimi i zbatimit të rregullores, Komisioni është duke punuar në procesin e verifikimit të diplomave, me ndihmën e ECMI Kosovës. Deri në maj 2018, nga gjithsej 1418 kërkesave për verifikim, 1075 diploma janë verifikuar, me rezultat pozitiv. Nga 8 maj 2018, Qeveria e Kosovës ia ka vazhduar mandatin Komisionit për verifikimin e diplomave edhe për një vit. Këto shifra tregojnë rëndësinë dhe suksesin e procesit të verifikimit në arritjen tek të diplomuarit në UMV. Megjithatë, jo vetëm që procesi i verifikimit ka arritur tek shumë të diplomuar brenda një periudhe të shkurtër kohe, por gjithashtu ka përmirësuar ndjeshëm qasjen e atyre që kanë aplikuar për këtë në punësim dhe arsimim. Sipas dy anketave me të diplomuar diplomat e të cilëve janë verifikuar, të kryera nga ECMI Kosova gjatë dhjetorit 2016 dhe prillit 2017, nga 269 persona që kanë aplikuar për verifikim 43% e tyre (115 të tillë) kanë përdorur diplomat për të aplikuar për vende pune. 15% (40 persona që kanë aplikuar për verifikim) kanë deklaruar se kanë përdorur diplomat e tyre të verifikuara për të hyrë në provime të mëtejshme profesionale në Kosovë, 25% e tyre (68 persona që kanë aplikuar për verifikim) kanë deklaruar se kanë qenë të punësuar dhe kanë përdorur diplomat e verifikuara për të rregulluar statusin e tyre në vendet aktuale të punës, ndërsa 17% (46 persona që kanë aplikuar për verifikim) kanë konfirmuar se kanë arritur të gjejnë punë pas verifikimit të diplomave të tyre.

ECMI Kosova luan një rol kyç në këtë proces. Organizata bashkëpunon ngushtë me Qeverinë e Kosovës dhe ka marrë përgjegjësitë jetike, duke vepruar si ndërmjetës mes UMV-së, të diplomuarve dhe agjencive qeveritare. Në kuadër të procesit aktual, të


Përdorimi i diplomave të verifikuara	Numri	%
Aplikimet për punësim	115	43%
Verifikimi i statusit	68	25%
Vende pune të siguruara	46	17%
Provime shtesë	40	15%
Gjithsej	269	100%

dipomuarit dorëzojnë një kopje të diplomës në Komunën e tyre. Nëpërmjet Sekretariatit të Komisionit të Pavarur për verifikimin e diplomave, kopjet e diplomave i përcillen ECMI Kosovës në Prishtinë. ECMI aktualisht nuk ka mandat të pranojë kërkesa për verifikim drejtpërdrejt nga aplikuesit.⁹

⁹ ECMI Kosova. 2016. Procesi i verifikimit të diplomave. Në dispozicion në: <http://www.ecmikosovo.org/en/Studies-and-handbooks/-Diploma-Verification-Process>

Në konsultim me departamentin përkatës të Universitetit të Mitrovicës Veriore, ECMI konfirmon se diplomat janë të besueshme dhe ia kthen dokumentet Sekretariatit. Komisioni i Pavarur për verifikimin e diplomave pastaj shqyrton dokumentet e kthyer dhe, nëse përmbushen kriteret, zyrtarizon verifikimin e diplomës.¹⁰

KOMISIONI PËR VERIFIKIMIN E DIPLOMAVE TË LËSHUARA NGA UNIVERSITETI I MITROVICËS SË VERIUT



3. ECMI DHE ARSIMIMI I KOMUNISTEVE JO-SHUMICË NË KOSOVË

Përveç kontributit të ECMI Kosovës si ndërmjetës në procesin e administrimit të verifikimit të diplomave, ne si OJQ kemi ndërmarrë një sërë veprimesh të rëndësishme, krahas kësaj, për të zgjidhur problemet praktike të dala nga mosmarrëveshjet politike që ndërlidhen me arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë. Si pjesë e përpjekjeve të saj më të gjera për të drejtat e minoriteteve dhe barazinë arsim, ECMI Kosova aktualisht është duke punuar në një kuadër më të gjerë të mbështetjes përmes një projekti të financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Prishtinë.

¹⁰ Andric, M. 18 maj 2017. 'Accountability Sofa: Diploma Verification', në dispozicion në: <http://www.ngoaktiv.org/news/accountability-sofa-diploma-verification> [Accessed 02/05/2018] [qasur më 02/05/2018]

Ky projekt synon përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në gjuhën serbe në Kosovë dhe rritjen e punësimit të të diplomuarve, me qëllimin që të punohet drejt zhvillimit të një kornize rregullatore që do të mbulojë jo vetëm UMV-në, por edhe institucionete tjera të arsimit të lartë, kolegjet dhe shkollat profesionale. Përveç mbështetjes teknike për punën e Komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga UMV dhe ofrimit të këshillave Qeverisë së Kosovës për politikën e përdorimit të gjuhës serbe, përmes këtij projekti gjithashtu synojmë të shikojmë përtej verifikimit të diplomave dhe të trajtojmë çështjet e arsimit nga një perspektivë më e gjerë.

Në vitin 2018, ne si organizatë kemi kryer një hulumtim original novator përmes të cilit kemi ofruar një pasqyrë dhe kemi vlerësuar gjendjen dhe cilësinë e arsimit në gjuhën serbe në Kosovë, për herë të parë që nga viti 1999. Përmes intervistave me grupe të interesit, statistikave dhe informatave demografike, si dhe analizimit të materialeve mësimore, infrastrukturës e objekteve shkollore, normave të braktisjes dhe të investimeve, hulumtimi sjell në një vend të gjitha informatat në dispozicion, dhe për herë të parë jep një pasqyrë të plotë të kushteve, problemeve dhe drejtimit që duhet dhënë arsimimit në gjuhën serbe në vend. Publikimi përkatës është në përgatitje e sipër dhe do të ndihmojë politikë-bërësit, autoritetet kosovare dhe ato serbe, si dhe BE-në, në përpjekjet e tyre për të zhbllokuar dialogun ndërmjet dy vendeve në fushën e arsimit.

Krejt në fund, por jo me më pak rëndësi, duke qenë se rëndësia e zhvillimit të vazhdueshëm është çdoherë në qendër të veprimit të ECMI-së, ne si OJQ kemi vendosur partneritet me Universitetin e Flensburgut (Europa-Universität Flensburg, EUF) në veri të Gjermanisë, për të lehtësuar ngritjen e kapaciteteve të UMV-së. Universiteti i Flensburgut është zgjedhur jo vetëm për shkak të reputacionit të tij si qendër e respektuar kërkimore për trajnimin e mësimdhënësve, por, ajo që është më e rëndësishmja, për shkak të përvojës së tij të gjatë në ofrimin e arsimit dygjuhësh, të njohur reciprokisht. Si i tillë, ai është bërë shembull edukativ i praktikës së mirë në bashkëjetesën e dy institucioneve të ndryshme arsimore në një rajon kufitar. Si pjesë e këtij bashkëpunimi, ECMI ka organizuar një vizitë studimore treditore në EUF (26-28 shtator 2017), ku përfshiheshin mbledhje të stafit të lartë akademik nga UMV me kolegjet e tyre përkatës nga Universiteti i Flensburgut dhe Universiteti i Danimarkës Jugore.

4. E ARDHME SFIDUESE

Arsimi i cilësisë së lartë është një nga objektivat kryesore qeveritare për prosperitet në Kosovë, ndonëse kufizimet buxhetore shpesh pengojnë përparimet. Sipas Planit Strategjik të Arsimit (PSAK) 2017-2021, i cili përbën një udhërrëfyes për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit arsimor të Kosovës, reformat lidhen me një sërë objektivash ambicioze për rritjen përfshirjes gjinore dhe etnike, si dhe uljen drastike të shkallës së braktisjes.¹¹ Në aspektin e performancës së arsimit të lartë, Raporti i BE-së për Kosovën i vitit 2018 vë në dukje se ndonëse raporti i studentëve në AL në raport me popullsinë e përgjithshme është i dyfishtë në krahasim me mesataren e BE-së, normat e përfundimit të arsimit të tij mbeten të ulëta, dhe shkalla e lartë e papunësisë në mesin e të diplomuarve nga kolegjet profesionale (25%) tregojnë një mospërputhje në mes të programeve të AL dhe kërkesave të tregut të punës.¹² Vendimet e Qeverisë, të kohëve të fundit, kanë shpjerë në shpërputhje të mëtejshme ndërmjet asaj se si funksionon sistemi arsimor kombëtar dhe rregullave të BE-së. Siç është vënë në dukje në Raportin e KE-së për Kosovën 2018, në vitin 2017 Qeveria kishte shkarkuar tërë bordin dhe U.D. Drejtorin e Agjencisë për Akreditimin e Arsimit të Lartë (AAK), agjenci kjo që mbikëqyr përpjekjet e Kosovës për t'iu përmbajtur standardeve të BE-së. Ky veprim ka minuar autonominë e Agjencisë dhe ka çuar në përjashtimin e saj nga Regjistri Evropian i Cilësisë së Arsimit të Lartë (EQAR), fakt ky veçanërisht shqetësues pasi që Arsimi i Lartë konsiderohet sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik në Kosovë. një agjenci mbikëqyrjen përpjekjet e Kosovës për të respektuar nga standardet e BE. Ky veprim ka dëmtuar autonominë e Agjencisë dhe ka çuar në përjashtimin e saj nga Sigurimin Regjistrin e Cilësisë Evropiane të Arsimit të Lartë (EQAR), një fakt veçanërisht shqetësuese pasi i Arsimit të Lartë është konsideruar si një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik në Kosovë. një agjenci mbikëqyrjen përpjekjet e Kosovës për të respektuar nga standardet e BE. Ky veprim ka dëmtuar autonominë e Agjencisë dhe ka çuar në përjashtimin e saj nga Sigurimin Regjistrin e Cilësisë Evropiane të Arsimit të Lartë (EQAR), një fakt veçanërisht shqetësuese pasi i Arsimit të Lartë është konsideruar si një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik në Kosovë.¹³

¹¹ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. 2016. Plani i Veprimit i Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017- 2021, fq. 2

¹² Komisioni Evropian, 17.04.2018. Dokument pune i stafit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2018, fq. 62

¹³ Komisioni Evropian, 17.04.2018. Dokument pune i stafit të Komisionit: Raporti për Kosovën 2018, fq. 62-63

Raporti i KE-së gjithashtu vë në dukje se njohja e diplomave, çështje kjo e një rëndësie të madhe në procesin e përgjithshëm të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, ka mbetur e pazgjidhur.¹⁴ Duke qenë se verifikimi i diplomave profesional rrjedh nga po e njëjta pavendosmëri në lidhje me marrëdhëniet e institucioneve arsimore të Kosovës me ato homologe të Serbisë, verifikimi vazhdon të jetë një çështje shumë politike, e ndërlidhur me marrëdhëniet e përgjithshme mes dy vendeve, dhe që shkakton shqetësime të dukshme për qytetarët e Kosovës.

Me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sukseseve të arritura – si në kuptimin e numrave ashtu edhe në kuptim të ndikimit real – në procesin në vazhdim e sipër të verifikimit, por gjithashtu duke pasur parasysh procesin burokratik dhe që merr shumë kohë, ECMI Kosova është duke krijuar një model të ri për një proces më efikas, më të lehtë dhe më të lehtë për të punuar me të. Megjithatë, deri më sot Qeveria nuk duket se ka vendosur objektiva të veçantë për rritjen e efikasitetit të administrimit të verifikimit të diplomave, e as që ka plane për një zgjidhje graduale të problemit. Çështje të rëndësishme të barazisë arsimore sipas ligjit, si dhe të qasjes së barabartë në tregun e punës, duhet të vendosen dhe të financohen në baza vjetore, gjë që është një nga çështjet që ECMI Kosova shqyrton gjatë procesit të verifikimit të diplomave, në formën se si funksionon aktualisht.

ECMI Kosova vazhdon monitorimin nga afër të zhvillimeve në sektorin e arsimit të lartë. Në të njëjtën kohë, ne si OJQ e kemi parasysh se ndonëse verifikimi i diplomave ka qenë një histori suksesi për Universitetin e Mitrovicës së Veriut, kjo nuk e bën më pak të rëndësishëm faktin se ka shumë vend për përmirësime. Aktualisht në Kosovë shkollat fillore dhe të mesme që japin mësim në gjuhën serbe nuk mbulohe nga legjislacioni ekzistues për verifikimin e diplomave profesionale, dhe prandaj diplomat e lëshuara nga këto shkolla akoma nuk njihen. Po kështu, ky legjislacion nuk mbulon as tri kolegje profesionale në gjuhën serbe (Kolegjin të Studimeve Profesionale Ekonomike nga Peja – Leposaviqi, Kolegjin Teknik të Studimeve Profesionale nga Ferizaj-Leposaviqi, Kolegjin Teknik të Tregtisë në Zveçan).

¹⁴ ibid. p. 48

Siç vë në dukje Raporti i KE-së për Kosovën 2018 në vlerësimin e progresit, sistemi arsimor i Kosovës përgjithësisht po përballet me një sërë sfidash të ndryshme, dhe ECMI Kosova synon të përfshijë këtë çështje shumë të rëndësishme të arsimit në gjuhën serbe në mesin e problemeve të ngutshme që duhet të diskutohen dhe të përfshihen në masat që duhet ndërmarrë në të ardhmen, derisa të dilet me një zgjidhje të realizueshme.



EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

ECMI Kosovo
Rr. Zahir Pajaziti, Nr. 20, Banesa 5
10000 Prishtinë/Pristina, Kosovo
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Kralja Petra 183a
38220 Mitrovica/ë North, Kosovo

Email: info@ecmikosovo.org
Web: www.ecmikosovo.org